



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATE/A:	25.04.2017
REFERENC-Ë:	45/4
PËR/ZA/TO:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
GA/OD/FROM:	Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rekomandimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë

Po ju dërgojmë Rekomandimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturore nr.180 të dt.21.04.2017 për lëndën e Këshillit të Bashkësisë Islame nga Prizreni Nr.04-353-16.

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Rekomandimit.



180

21.04.2017

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta - Ministry of Culture, Youth and Sports
Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve / Kosovo Institute for Protection of
Monuments / Institut Kosova za Zastitu Spomenika

DATE/A:	19.04.2017
REFERENC-Ë:	08/2017 - Takimi i tetë
PËR/ZA/TO:	Z. Agim GËRGURI - U.D. Drejtor i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve.
CC:	Z. Bislim BISLIMI - Udhëheqës i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit / DL MKRS, anëtar i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Projekteve dhe Kërkesave Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM; Znj. Zana LLONÇARI OSMANI- Zyrtare e Lartë në Departamentin e Trashëgimisë Kulturore - MKRS, anëtare e Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Projekteve dhe Kërkesave Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM;
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Znj. Teuta SELMANAJ - Zyrtare Ligjore në IKMM, përgjegjëse për mbështetjen administrative të punës së Komisionit.
NGA/OD/FROM:	Znj. Merita AUGUSTININRECAJ- Kryesuese e Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Projekteve dhe Kërkesave Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rekomandimet e Komisionit, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave / projekteve: Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Prizren

I nderuar Drejtor z. Gërguri,

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Projekteve dhe Kërkesave Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore (në tekstin e mëtejme Komisioni) i emëruar me Vendimin Nr. 01/2016 të datës 13.04.2016, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin tjetër Nr. 52/2016 të datës 04.10.2016 me Nr. të protokollit 376, ka zhvilluar takimin e tetë(8) punues me datë 03.04.2017, ku janë shqyrtuar kërkesat dhe projektet e Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore (QRTK)- Prizren. Janë dhënë rekomandimet si në vijm:

Rreth kërkesës Nr. 1. QRTK -Prizren:

1. Këshilli i Bashkësisë Islame nga Prizreni ka parashtruar kërkesë për dhënien e pëlqimit për ndërtimin e aneksit të Medresesë "Alaudin" në ngastren kadastrale 4236 - 0 Z.K Prizren. Objekti është në rrugën "Ismet Jashari - Kumanova", pranë Xhamisë së Terzi Mahallës, ndërtimi i aneksit, sic është paraqitur nga parashtruesi, nevojitet për t'i përmbushur nevojat e Medresesë "Alaudin". Parcela ku kerkohet të ndërtohet aneksi gjendet brenda zonës mbrojtëse të Xhamisë së Terzi Mahallës, objekt ky në listen e MKRS-së, "Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme" (10.10.2016 - 10.10.2017). Nga komisioni kërkohet vlerësimi i projektit ideor për ndërtimin e këtij aneksi. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, komisioni cilëson se aneksi i paraparë të ndërtohet me projektin ideor të prezentuar tejkalon kriteret për ndërtim në zonat mbrojtëse të monumenteve. Konkretisht, zgjidhja e propozuar të shtohet, pengon kuadrin vizuel të xhamisë dhe e konkurn ate në përmasë.

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese - Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës, ka rekomanduar si më poshtë

1. Të refuzohet Projekti ideor për dhënien e pëlqimit për ndërtimin e aneksit në Medresën Alaudin, i cili tejkalon kriteret për ndërtim në zonat mbrojtëse të monumenteve;
2. Të udhëzohet pala, në rast se e çmon të nevojshme, të prezantojë në Komisionin Projektin Ideor i cili duhet të jetë në harmoni me Ligjin Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, sidomos me nenet 2.21 dhe 6.4, të cilat kufizojnë qartë aktivitetet /ndërtimet e reja në Zonat Mbrojtëse të Monumenteve, pra, të njëjtat nuk guxojnë të dëmtojnë kuadrin e dukshëm të monumentit, si dhe as vlerat dhe karakterin e tij.
3. Njoftohet pala se kriteret për ndërtim në zonën mbrojtëse të monumentit, sa i përket ruajtjes së kuadrit vizuel të xhamisë në fjalë janë:
 - Ndërtesa nuk mund të tejkalojë etazhitetin P+1, pra konkretisht, lartësia e aneksit nuk mund të tejkalojë lartësinë e strehës së kupolës së Xhamisë së Terzi Mahallës
 - Mbulesa e aneksit (kulmi) duhet të ketë rënje 20°-30°